



UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 7

UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 7

LevizAlbania

Korrik 2020

UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 7

Ky udhëzues shërben për të ofruar informacionet e nevojshme për të gjithë të interesuarit për të aplikuar me koncept-ide në Thirrjen për Aplikime Nr. 7, të LevizAlbania. Udhëzuesi shpjegon hapat, procedurat, dokumentacionin e kërkuar, rregullat dhe afatet e të gjithë procesit të Thirrjes, që nga hapja e saj, fazat pasardhëse dhe deri në përfundimin e saj.

Ky udhëzues është i rëndësishëm për të gjitha ato Organizata Jofitimprurëse, Grupe informale dhe Individë që janë të interesuar të aplikojnë pranë LevizAlbania. Të gjithë janë të lutur që për çdo informacion apo paqartësi të na shkruajnë në info@levizalbania.al ose të kontaktojnë në numrin e telefonit +355 44 500 153.

1. Kush mund të aplikojë ?

LevizAlbania mbështet përmes instrumentave të granteve, organizatat e shoqërisë civile (OJF)¹, grupet informale² dhe individët.

Organizatat e shoqërisë civile (OJF), organizatat me bazë në komunitet, organizatat e reja, grupet e të rinjve dhe të grave, individët apo grupimet e tyre, lëvizjet qytetare, grupe të ndryshme interesi, etj., në zona urbane e rurale, janë të gjithë të ftuar dhe kanë mundësinë të aplikojnë në këtë Thirrje të LevizAlbania.

Në këtë Udhëzues, në vijim, janë përcaktuar shprehimisht rastet e mospërputhshmërisë për aplikim.

2. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikimeve:

Thirrja është e hapur nga data 15 Korrik, 2020 deri në datën 5 Gusht, 2020 (deri në orën 23:59).

Aplikimi bëhet **VETËM** në formatin **ONLINE**. Për të aplikuar ONLINE duhet të vizitoni faqen zyrtare www.levizalbania.al dhe të klikoni në rubrikën Thirrja për Aplikime Nr. 7.

Formati i aplikimit ONLINE është i disponueshem në fund të tekstit të Thirrjes Nr. 7, të publikuar në këtë rubrikë.

Instruksione të rëndësishme për formatin e aplikimit ONLINE:

- Bëni kujdes në përzgjedhjen e një prej Drejtimeve të Thirrjes;
- Në përzgjedhjen e zonës së zbatimit, për më shumë se një (1) bashki duhet të mbani të shtypur në tastierën e kompjuterit butonin CTRL dhe më pas përmes MOUSE-it të përzgjidhni bashkitë e planifikuara. Në rast se idea juaj ka një shtrirje kombëtare, ky opsion ndodhet në krye të

¹ Organizata të shoqërisë civile janë ato organizata që janë regjistruar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar për organizatat jofitimprurëse dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Shqipërisë.

² Grup informal është një grupim qytetesh aktivë që ndajnë të njëjtat vlera dhe parime, dhe që veprojnë sëbashku për të adresuar çështje e probleme social ekonomike në komunitetin dhe/ose fushën e tyre. Grupi nuk është i regjistruar në gjykatë, dhe qëllimi i veprimtarisë së tij nuk është fitimprurës.

UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 7

kategorisë “zona e zbatimit”. Në aplikimet përmes telefonit mobile mjafton të klikoni njëherë mbi çdo bashki për përzgjedhjen e shumëfishtë;

- Në vendosjen e vlerës financiare të kërkuar për mbështetjen e koncept-idesë, në këtë fazë të aplikimit duhet vendosur vetëm një vlerë numerike, shembull: 25500 (pa presje dhjetore, pa pika, pa viza në pjesën e poshtme të numrave apo në mesin e tyre);
- Respektoni limitin e karaktereve për secilën fushë që duhet të plotësoni. Limiti ndryshon për secilën prej fushave boshe sipas specifikimeve përkatëse, dhe në rast të tejkalimit të tij, sistemi nuk do t’ju lejojë të vijoni shkrimin;
- Aplikanti OJF, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit vendimin më të fundit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi organizatën, në formatin JPG (fotografi) ose PDF;
- Aplikanti GRUP INFORMAL, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit një CV të personit që drejton/koordinon Grupin, si dhe një CV të vetë Grupit informal (duke përfshirë aktivitete të mëparshme të grupit, si dhe emrat e anetarëve të grupit), në formatin PDF ose Microsoft Word;
- Aplikanti INDIVID, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit CV-në përkatëse, në formatin PDF ose Microsoft Word;
- **KUJDES:** Të gjitha fushat për tu plotësuar gjatë aplikimit janë të shenjua me shenjën* (Asterix) dhe janë të detyrueshme për tu plotësuar, në rast të mos plotësimit të këtyre fushave nuk do të mundeni të përfundoni APLIKIMIN tuaj;
- Në përfundim mjafton të klikoni “APLIKO” dhe keni përfunduar;
- Pas dërgimit të aplikimit do t’ju mbërrijë në adresën e postës elektronike të vendosur në aplikim, mesazhi nga serveri i LevizAlbania: “Faleminderit që Aplikuat” dhe bashkëlidhur do të jetë një kopje e aplikimit. Mesazhi konfirmon se aplikimi juaj ka qenë i suksesshëm dhe ka mbërritur pranë LevizAlbania.

3. Drejtimit e Thirrjes

Vëmendje: Drejtimit e Thirrjes përfaqësojnë objektivat që LevizAlbania synon të arrijë përmes ideve/nismave në kuadër të mbështetjes së aktorëve të shoqërisë civile, grupimeve informale dhe individëve.

LevizAlbania projekti i Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, i zbatuar nga një konsorcium i tre organizatave shqiptare, “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA”, “Partnerët Shqipëri për Zhvillim dhe Bashkëpunim” si dhe “Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit”, shpall thirrjen për Aplikime nr.7. Në Thirrjen për Aplikime të mëparshme u paraqitën 379 aplikime me konceptide, nga të cilat 126 u kualifikuan për në konkurset e ideve. Për thirrjen e mëparshme për aplikime u përzgjedhën 40 projekte fituese, të cilat janë në zbatim në 36 bashki të vendit.

LevizAlbania do të vijojë të mbështesë aktorët e shoqërisë civile, duke inkurajuar gratë dhe të rinjtë dhe mobilizimin e komuniteteve me një qasje nga poshtë-lart për të arritur rezultatet e mëposhtme:

- Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë politikën dhe vendimmarrjen në vetqeverisjen vendore;

UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 7

- Përfshirja e mekanizmave të qëndrueshëm për pjesëmarrjen qytetare, transparencën dhe llogaridhënien në qeverisjen vendore;
- Bashkitë i përgjigjen kërkesës qytetare;
- Barrierat strukturore për demokracinë vendore janë identifikuar dhe adresuar nga qytetarët dhe autoritetet publike;
- Advokim bazuar në të dhëna për një qeverisjes vendore transparente dhe llogaridhënëse;
- Forcim i aktivizimit të të rinjve për të ndikuar në proceset vendimmarrëse.

Duke synuar fuqizimin e aktorëve të shoqërisë civile në nivel vendor për të kërkuar qeverisje më të mirë vendore, LevizAlbania fton të gjithë organizatat jo-fitimprurëse, grupet informale dhe individë të cilët janë aktivë në komunitetin e tyre, të aplikojnë në **Thirrjen për Aplikime Nr. 7**

Në qendër të Thirrjes për Aplikime Nr. 7 do të jetë Advokimi, si një proces i cili kanalizon përpjekjet për ndikimin e politikave dhe proceseve vendore. Advokimi vjen si një instrument në këtë rast, në shërbim të komuniteteve qytetare për të kërkuar veprimin e qeverisjes vendore për çështjet që këto komunitete shohin me interes. Advokimi si instrument synohet të përdoret, duke pasur si katalizatorë organizatat apo grupet informale, në dy forma:

- a. Përmes angazhimit të organizatave **si ndërmjetës** të qytetarëve dhe vetqeverisjes vendore, për të ndikuar mbi çështje me rëndësi;
- b. Përmes angazhimit të organizatave dhe grupeve informale **si mbështetës** të qytetarëve për të ndërvepruar me vetqeverisjen vendore, për të ndikuar mbi çështje me rëndësi;

Duke synuar në qasje holistike në angazhimin e qytetarëve në nivel lokal në forma të ndryshme advokuese, presioni mund të vij:

- a. **për qytetarët**, ku organizatat e shoqërisë civile hartojnë dokumentë analitikë në ndihmë të qytetarëve për të qenë të informuar gjatë proceseve advokuese që ndërmarrin më pas, duke ofruar zgjidhje dhe modele konkrete;
- b. **me qytetarët**, ku organizatat dhe qytetarët ndërveprojnë për të advokuar, duke luajtur rol propozues dhe kërkues përkundrejt institucioneve vendore;
- c. **prej qytetarëve**, si nismëtar të nismave advokuese, bazuar në propozime, shembuj vetjak dhe aksion;

➤ **Drejtimit e Thirrjes për Aplikim**

Drejtimi 1: Nisma advokuese bashkëpunuese që synojnë përcaktimin e prioriteteve në proceset vendimmarrëse vendore dhe krijimin e modeleve të reja funksionale, në kuadër të garantimit të të drejtave social-ekonomike për qytetarët dhe grupet vulnerabël.

Ky drejtim synon adresimin e çështjeve që lidhen me të drejtat social-ekonomike të qytetarëve në përgjithësi dhe grupeve vulnerable në veçanti, përmes angazhimit qytetar që ndërmer nisma që advokojnë bazuar në prova/fakte të përfuara përmes analizave, studimeve, raporteve monitoruese, etj., duke synuar ndërveprim bashkëpunues me vetqeverisjen vendore.

Ndërhyrjet nën këtë Drejtim përfshijnë realizimin e dokumenteve analitike (analiza, studime, monitorime, raporte, etj.) me qëllim përdorimin e tyre për të ndërmarë nisma dhe fushata advokimi si dhe krijimin e modeleve të reja mbi ushtrimin e funksioneve apo pëmirësimin e shërbimeve nga strukturat e qeverisjes vendore, duke mbajtur në konsideratë edhe nevojën për të ripërcaktuar rolin e bashkive në marrëdhënien me qytetarin. Forcimi i grupeve të ndryshme, përmes angazhimit konkret, duhet të synojë krijimin e legjitimitet në komunitetin përkatës.

Idetë e propozuara nga organizata të konsoliduara apo organizatat të reja që punojnë komunitet, duhet të synojnë angazhimin qytetar në adresimin e çështjeve me rëndësi, duke i bërë qytetarët aktorë aktiv në paraqitjen e propozimeve, në dhënien e shembujve konkret të angazhimit, në mobilizim dhe në ndërmarrjen e aksioneve konkrete për të përmirësuar një situatë apo problematikë të identifikuar.

Ndër të tjera, vëmendje në këtë Drejtim, merr advokimi bashkëpunues dhe lobimi për të përmirësuar përgjigjen e vetqeverisjes vendore ndaj impaktit të situatave të krizave apo emergjencave. Ndërhyrjet nën këtë drejtim duhet të targetojnë çështje që lidhen me vetqeverisjen vendore, duke përfshirë të gjitha njësitë vendore brenda një Qarku. Më poshtë një listë sugjeruese, por jo shteruese:

- Raportet e monitorimit të bazuara në prova mbi qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve të NJQV-ve, përfshirë Këshillin Bashkiak, Administratorët e Bashkive dhe Njësitë Administrative, në drejtim të ofrimit të shërbimit publik, proceset e vendimmarrjes, zbatimin e planeve lokale sociale dhe ekonomike, konsultimet publike, etj., si bazë për të nxitur aktivizmin qytetar, paraqitjen e modeleve, dhënien e shembujve pozitiv nga komuniteti, etj.
- Advokim për të përparuar në lidhje me ndryshimet ligjore të nevojshme për ushtrim e funksioneve nga NJQV-të;
- Ndërgjegjësimi, edukimi dhe mobilizimi i organizatave lokale dhe qytetarëve në sensibilizimin në fushën e mbrojtjes mjedisore (krimi mjedisor, ndryshimet klimatike, menaxhimin e mbetjeve, etj.)
- Nxitje e dialogut ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike në procesin decentralizimit;
- Nxitja e diskutimit të çështjeve të rëndësishme të nivelit vendor në diskursin zgjedhor kombëtar të vitit të ardhshëm.

Organizatat aplikuese të synuara në këtë drejtim janë organizata me kapacitete/mundësi për advokim. Aplikuesi mund të jetë një organizatë me qendër brenda qarkut ku propozohet të realizohet ndërhyrja, ose të aplikojë në partneritet me një organizatë të vendosur në qarkun ku propozohet të realizohet ndërhyrja.

Organizatat aplikuese nën këtë Drejtim do të shërbejnë si ndërlidhëse/ndërmjetëse (urë komunikimi) mes qytetarëve dhe vetqeverisjes vendore.

Drejtimi 2: Nxitja e aktivizmit dhe angazhimit qytetar për një demokraci vendore më funksionale dhe të qëndrueshme

UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 7

Ky drejtim synon të nxisë aktivizimin dhe të rrisë mundësitë e qytetarëve në nivel vendor për të vepruar dhe për të kërkuar prej institucioneve të qeverisjes vendore të përmbushin kompetencat e tyre me transparencë, të jenë llogaridhënëse ndaj qytetarëve, si dhe të garantojnë përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Ndërhyrjet nën këtë Drejtim përfshijnë mobilizimin dhe fuqizimin e qytetarëve, si dhe përdorimin e instrumentave ligjor si dëgjuesat dhe konsultimet publike, peticionet (edhe online), nismat qytetare, etj. Vëmendje në këtë Drejtim merr adresimi i çështjeve të cilat kanë interes/legjitimitet të gjerë të qytetarëve dhe shfrytëzohet momenti i duhur për të ngritur kërkesa ndaj qeverisjes vendore dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e hapave të ndërmarrë.

Idetë e propozuara duhet të synojnë angazhimin qytetar në adresimin e çështjeve me rëndësi për komunitetin, duke i bërë qytetarët aktorë aktiv në paraqitjen e propozimeve, në dhënien e shembujve konkret të angazhimit, në mobilizim dhe në ndërmarrjen e aksioneve konkrete për të përmirësuar një situatë apo problematikë të identifikuar.

Ndërhyrjet e propozuara duhet të targetojnë çështje që lidhen me qeverisjen vendore në një Bashki të caktuar. Aplikantët që propozojnë ndërhyrje në më shumë se një Bashki, duhet të argumentojnë nevojën për ndërhyrjen e propozuar dhe ndërlidhjen midis Bashkive të targetuara. Më poshtë një listë sugjeruese, por jo shtruese;

- Përfshirja aktive dhe pjesëmarrja e qytetarëve në përcaktimin e prioriteteve dhe vendimmarrjen në nivelin lokal, përmes mekanizmave pjesëmarrës dhe / ose instrumenteve ligjore (peticione, këshillat bashkiakë që takojnë pjesëmarrjen, dëgjimet publike, nismat e qytetarëve, etj.)
- Fuqizimi i komuniteteve për të ushtruar presion qytetar mbi autoritetet lokale për t'iu përgjigjur kërkesave dhe të drejtave të tyre (p.sh., përmes edukimit qytetar, fuqizimit ligjor, stërvitjes, rrjetëzimit, mbështetjes për veprime konkrete, etj.)
- Inicimi ose mbështetja e lëvizjeve shoqërore apo komunitare, koalicionet e aktorëve qytetarë dhe / ose fushatat e përbashkëta që synojnë të adresojnë çështjet dhe nevojat e komunitetit;
- Nxitja e diskutimit të çështjeve të rëndësishme të nivelit vendor në diskursin zgjedhor kombëtar të vitit të ardhshëm.

Aplikantët e synuar në këtë drejtim janë organizatat e shoqërisë civile dhe grupet informale që punojnë në territoret e tyre drejtëpërdrejtë me komunitetin duke ndikuar përmes mobilizimit në rritjen e kapaciteteve reaguese të qytetarëve për të kërkuar përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe transparencë prej të zgjedhurve vendorë. Aplikuesi mund të jetë një organizatë/grupim informal i vendosur në Bashkinë ku propozohet të realizohet ndërhyrja.

Në rastet e angazhimit të OJF-ve që planifikojnë të zbatojnë projekte jashtë zonës së qarkut ku operojnë, ato mund të jenë partnere me OJF-të lokale. OJF-të lokale duhet të jenë aplikantë lider dhe të kenë rol kryesor në zbatim, rol ky që do reflektohet edhe në kontratë dhe në administrimin e buxhetit. Roli i organizatave të konsoliduara duhet të jetë i përqendruar në mbështetje dhe ekspertizë

Aplikantët nën këtë Drejtim do të shërbejnë si nxitës të qytetarëve për të rritur kërkesën ndaj qeverisjes vendore, duke propozuar zgjidhje dhe modele konkrete.

Drejtimi 3: Aksioni Komunitar përmes angazhimit të drejtëdrejtë të individëve në nisma/kausa përfaqësuese për komunitetin lokal

Ky drejtim synon *angazhimin e qytetarëve aktivë* në nivelin e komuniteteve më të vogla (lagje, zona rurale), që të mobilizojnë grupe ose individë, që japin propozime konkrete dhe i kërkojnë bashkisë adresimin dhe zgjidhjen e problemeve në këto komunitete. Ky drejtim ofron mbështetje për aksione qytetare në komunitete të caktuara, të cilët ndajnë një shqetësim apo problematikë dhe që kanë nevojë për mbështetje dhe mentorim për të arritur rezultate konkrete dhe sjellë ndryshimin.

Grantet për Aksionin Komunitar ofrojnë një financim bazë dhe do të shoqërohen me mentorim dhe mbështetje teknike nga LevizAlbania gjatë zbatimit të projektit.

ANALIZA E PËRGJITHSHME E KONTEKSTIT

Shqipëria vijon të mbetet një vend ku demokracia paraqitet problematike, e në veçanti demokracia vendore mbetet hibride. Elementet kryesorë kontekstuale të kësaj periudhe dhe referenca për periudhën vijuese sillen rreth zhvillimeve politike, mjedisit veprues të shoqërisë civile si dhe rreth situatave të jashtëzakonshme dhe krizave.

Zgjedhjet e fundit për organet e vetqeverisjes vendore, prodhuan një situatë qeverisëse vendore të përqëndruar nën drejtimin e kryetarëve të bashkive të kandiduar vetëm nga njëri krah politik, ashtu si edhe këshillat vendorë, përbërja e të cilëve është njëngjyrëshe. Çështjet zgjedhore mbeten ende me ndjeshmëri të lartë dhe ndër më të diskutuarat në vend. “Zgjedhjet e lira dhe demokratike janë parakusht për qeverisjen demokratike, pasi nëpërmjet tyre qytetarët zgjedhin lirisht dhe bazuar në parimet e demokracisë kandidatët që mund të qeverisin në mënyrë legjitime në emër dhe në interes të tyre³”.

“Këshilli Politik” i përbërë nga përfaqësues të forcave politike kryesore në Shqipëri, u angazhua për të realizuar një reformë zgjedhore bazuar në rekomandimet e OSBE/ODIHR si dhe për prodhimin e një marrëveshje politike⁴, që adreson pjesërisht rekomandimet, por njëkohësisht për të ç’tensionuar situatën politike dhe krijuar një mjedis konstruktiv të zhvillimit të procesit të ardhshëm zgjedhor në vend. Aspektet kryesore të marrëveshjes përfshijnë: mos ndryshimin e sistemit zgjedhor, mos ndryshimin e strukturës së komisioneve të ulëta të administrimit të zgjedhjeve, rritjen e financimit të partive politike me fonde publike e private si dhe lejimin e reklamave në media përgjatë fushatës zgjedhore. Në përfundim, reforma e propozuar, e cila pritet të votohet në Kuvendin e Shqipërisë në përfundim të kësaj legjislature, vendos që sistemi zgjedhor mbetet i njëjti, ashtu si listat e mbyllura të kandidimit dhe përbërja politike e komisioneve zgjedhore.

Mungesa e një reforme të thellë në sistemin zgjedhor e cila do të ndryshonte formulën e zgjedhjes dhe përfaqësimit, rrit pritshmëritë mbi rolin e shoqërisë civile gjatë fushatës zgjedhore për të

³ [Raport i Këshillit të Europës mbi Reformë Zgjedhore](#)

⁴ Marrëveshja pritet të votohet në parlament së shpejti. Në momentin e shpalljes së Thirrjes për Aplikime, ka pasur zhvillime politike e institucionale lidhur me aplikimin e listave të hapura në zgjedhje, duke ndërmarë edhe ndryshime kushtetuese.

adresuar çështje të përfaqësimit dhe ndikimit qytetar në zgjedhjet për vetqeverisjen vendore. Elementë të tillë si: informimi qytetar, pjesëmarrja qytetare në proceset zgjedhore, transparenca dhe përgjegjshmëria e kandidatëve, caktimi i prioriteteve vendore, llogaridhënia, etj., përbëjnë rolin ‘komplementar’ të shoqërisë civile në një proces zgjedhor demokratik. Pritshmëria e qytetarëve në këtë situatë evidenton marrjen këtij roli nga aktorët e shoqërisë civile, – të cilët do të duhet të informojnë, orientojnë dhe drejtojnë qytetarët drejt dialogut, përgjegjësisë dhe zgjedhjes së informuar. Shoqëria Civile duhet të jetë instrumenti garantues i demokracisë funksionale. Ajo duhet të luaj rol të rëndësishëm në identifikimin e çështjeve me rëndësi në nivelin vendor dhe të gjej mënyrën e duhur që këto çështje të adresohen në hapësirat e diskutimit kombëtar, duke shfrytëzuar hapësirat e diskutimit për zgjedhjet e ardhshme parlamentare (2021).

Media dhe organizatat e shoqërisë civile konsiderohen nga qytetarët si mekanizmat më efektivë të llogaridhënies, ushtrimit të presionit dhe ngritjes së zërit. Shumica e qytetarëve shqiptarë e konsiderojnë qeverisjen vendore si **jo transparente apo të përgjegjshme. 71% e qytetarëve shqiptarë nuk kanë parë përmirësim të cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia e tyre** dhe prej vitit 2017, përqindja e shqiptarëve që e konsiderojnë vetqeverisjen vendore si llogaridhënëse ka pësuar një rënie me **11 %** (*burimi IDM 2020*). Zhvillimi i proceseve konsultuese fiktive ka sjell një rënie të besimit të qytetarëve në këto procese shumë domethënëse për demokracinë vendore dhe përfshirjen qytetare në proceset vendimmarëse.

Një vlerësimi i dytë mbarëkombëtar i situatës së vetqeverisjes vendore në Shqipëri për vitin 2020 tregon se **Pjesëmarrja dhe Angazhimi Qytetarë mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2016** duke përfaqësuar ende dimensionin më të dobët të qeverisjes vendore. Situata e përgjithshme e angazhimit të qytetarëve ka rënë në nivelin “thujse dobët” kur bëhet fjalë për ndërveprimin e komunitetit me qeverisjen vendore apo Organizatat e Shoqërisë Civile.

Situata e muajve të fundit për shkak të pandemisë globale e cila preku edhe Shqipërinë ndikoi në të gjithë zinxhirin e funksionimit normal, jo vetëm të shoqërisë por edhe të institucioneve publike, politik-bërëse dhe vendimmarëse në nivel qendror dhe në qeverisjen vendore, si edhe ballafaqoi sektorin privat me shumë vështirësi dhe të panjohura. Situata e emergjencës solli një qasje elitiste⁵. Pushteti apo orientimi i vendimmarjes në nivel qendror edhe për çështje në varësi të plotë të nivelit vendor, me qëllim dhënien e përgjigjies ndaj situatës së emergjencës, si dhe duke i shtuar kësaj qasje drejtimin një partiak të qeverisjes vendore, ndikoi në dobësimin e sistemit të kontroleve, zvogëlimin e hapësirës ndërvepruese dhe kontrolluese të shoqërisë civile, duke prodhuar për rrjedhojë një demokracinë vendore të dobët.

⁵ Në vijim të studimeve tematike gjatë periudhës së COVID-19, Co-PLAN në bashkëpunim me Shoqatën e Autonomisë Vendore, kanë realizuar studimin “[Reagimi i Qeverive Vendore ndaj Emergjencës së Covid-19 në Shqipëri: Janar 2020 – Prill 2020](#)”. Aty theksohet se *Mbeten ende për t’u ndërmarrë vlerësime të strukturuar rreth qasjes së përdorur nga qeveria për të reaguar ndaj pandemisë. Megjithatë, kjo qasje ngjet më tepër me një qasje elitiste (Marisam, 2008), ku pushteti qendror merr përsipër të gjithë vendimmarjen lidhur me politikën e veprimet, sipas arsytimit të një grushti ekspertësh (përgjithësisht të shëndetësisë). Një qasjeje e tillë kufizon liritë dhe nuk lë vend për vendimmarje demokratike me argumentin se në këtë mënyrë në rast fatkeqësish, evitohet marzhi i lartë i gabimit në vlerësimin e riskut (po aty). Mirëpo, kjo qasje nuk arrin t’i vërë në përdorim njohuritë lokale rreth aspekteve të rëndësishme të vlerësimit të riskut, si dhe nuk merr parasysh vlerat dhe normat shoqërore, që normalisht duhen adresuar për të shmangur ndërlikime të mundshme etike.*

Gjatë pandemisë **pushteti vendor e orientoi veprimtarinë drejt prioriteteve bazike, ku vëmendje e veçantë ju kushtua ndihmës ekonomike dhe sociale të shtresave në nevojë**, dezinfektimit të rrugëve, menaxhimit të mbetjeve dhe sigurimit të mjeteve mbrojtëse dhe parandaluese për përhapjen e virusit. **Rreth 40% e bashkive⁶** kanë ndërmarrë rialokime buxhetore për të zvogëluar ndikimin e masave shtrënguese dhe izolimit në ekonomi. Masat lehtësuese fiskale, siç është ulja e taksave dhe përjashtimi nga tarifa e strehimit social, janë ndërmarrë për të lehtësuar efektet e bllokimit në biznes dhe nevojat e grupeve vulnerabel. Shpesh vendimmarrja në lidhje me këto masa është marrë në një kohë të shkurtër, pa konsultim dhe madje përtej kompetencave ligjore.

Gjithashtu, periudha e krizës së pandemisë dhe përqëndrimi i kapaciteve të njësive të qeverisjes vendore pa një orientim strategjik vetëm në përballimin e krizës (*shpërndarja e ndihmave, sensibilizimi i qytetarëve për respektimin e masave parandaluese të përhapjes së virusit*), evidentoi problematika në aspektin menaxherial për mbarëvajtjen e sektorëve të tjerë të komunitetit. Ky defekt prodhoi disa situata me impakt negativ në sektorë të ndryshëm komunitar, specifikisht në mjedis.

Disa raste u raportuan nga media (*PortaVendore*) por që ngjallën edhe reagim qytetar mbi shkeljet ligjore dhe dëmet mjedisore që u shkaktuan nga subjektet private. Çështjet mjedisore kanë një impakt social dhe ekonomik për vendin tonë, pasi dëmi që sjellin prek disa sektorë si turizmi, bujqësia, shëndetësia, etj.

Megjithatë, **kriza ka krijuar një shkëputje/krisje në marrëdhënien qytetarë - institucione të vetqeverisjes vendore**. Një numër i konsiderueshëm i të drejtave dhe lirive të qytetarëve u kufizua ose anulua plotësisht.

Gjatë periudhës së pandemisë ka pasur një reduktim të transparencës dhe llogaridhënies së veprimtarisë së qeverisjes vendore. Në këtë situatë emergjente, kjo periudhë është shoqëruar me mungesa informacioni në lidhje me mbledhjet e këshillave bashkiakë, vendimet e marra prej tyre në lidhje me alokimet buxhetore, mënyra e organizimit të mbledhjeve, procedurat e ndjekura, etj. Në procese të tilla si: hartimi i planeve buxhetore, përcaktimi i prioriteteve të bashkive, përcaktimi i përfitimeve për shtresa apo grupe të ndryshme, etj., dhe transparenca, përfshirja e grupeve të interesit bëhet shumë më e rëndësishme se më parë, duke konsideruar efektet ekonomike dhe sociale të pandemisë por edhe pamundësinë apo kapacitetin e NJQV-ve përballë situatave të pazakonta. Pavarësisht përpjekjeve të këshillave bashkiakë për të zhvilluar mbledhje në platforma on-line, një praktikë mjaft me vlerë, mbetet e nevojshme shtrirja e këtij modeli në të gjitha bashkitë, si dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarëse edhe në situata të jashtëzakonshme. Me situatën e pandemisë COVID-19, problematikat e këtyre çështjeve dolën edhe më shumë në sipërfaqe. Instrumentat ligjorë dhe praktikant në përdorim të konsideruara të stabilizuara, u vunë në diskutim serioz, duke u bërë praktikisht të papërdorshme. Kjo e thelloi më tej hendekun që ekzistonte edhe përpara pandemisë në këto çështje.

⁶ [Burimi: Bashki të Forta](#)

[*Sujekt ndryshimi për shkak të relevancës kohore të shpalljes së thirrjes dhe përfundimit të legjislatures kuvendore.](#)

Si pandemia e COVID-19 po ashtu edhe emergjenca e tërmeteve të vitit 2019 zbuluan mjaftueshëm defekte/mangësi në nivel politikash, reagimi, veprimi dhe menaxhimi prej strukturave të qeverisjes vendore. Këto situata të jashtëzakonshme pritet të japin efektet në sektorin ekonomik, për të cilin Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore kanë parashikuar vitin 2020 dhe 2021 si periudhë që ekonomia e vendit tonë do të kalojë në recesion, efekte që pritet të fillojnë të ndihen në fund të trejmuorit të tretë dhe tremujorit e katërt të vitit 2020. Në këtë këndvështrim bashkitë do të duhet të zhvillojnë një planifikim objektiv dhe realist mbi ndërhyrjet në aspektin social-ekonomik, proces në të cilin shoqëria civile, qytetarët dhe grupet interesit duhet të luajnë një rol pro-aktiv. I gjithë ky planifikim do të duhet të prioritetizojë ndërhyrjet të cilat i përgjigjen efekteve social-ekonomike, me vëmendje të veçantë për grupet vulnerabël dhe më të pamundurit për përballimin e situatave të krizës. Këto kriza evidentuan pikërisht nevojën për një ndryshim të qasjes së reagimit të bashkive në aspekte të ndryshme të ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve të tyre.

Në të gjithë këtë kontekst, nevoja për forcimin e legjitimitetit të organizatave të shoqërisë civile gjatë punës në terren është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për adresimin e çështjeve dhe problematikave që shqetësojnë qytetarët por edhe për rezultatin e pritshëm dhe ndryshimin e kërkuar prej këtyre të fundit.

Forcimi i legjitimitetit në një kohë të pazakontë ndërveprimi (*distancimit social dhe masave shtrënguese*) kërkon gjithashtu një investim më të madh prej OSHC-ve dhe mënyrave të operimit të tyre në terren. Implementimi i metodave inovative (online) për të kryer funksionin dhe realizuar angazhimin e tyre është tashmë një domosdoshmëri për të përmbushur nevojat e qytetarëve për përfshirje, transparencë dhe llogaridhënie të të zgjedhurve vendor.

Vlen të theksohet së përpos vështirësive dhe sfidave, janë regjistruar përpjekje të aktorëve të shoqërisë civile në drejtim të rritjes së kërkesave të qytetarëve për reagim dhe përgjegjshmëri prej pushteti vendor, të mbështetura nga OSHC-të të cilat kanë përdorur instrumentat alternative dhe dixhitale për adresimin e çështjeve dhe problemeve të tyre. Sipas një Raporti Vlerësimi të Partners Albania organizatat e shoqërisë civile kanë rritur kërkesën për të pasur një rol më aktiv në mbikqyrjen e qeverisjes, gjë që ka ardhur nga një rënie në demokracinë vendore⁷.

Në një kontekst të tillë, aktivizmi dhe angazhimi qytetar janë të domosdoshme si kundërvënie ndaj polarizimit politik dhe për të kultivuar një shoqëri civile me bazë komunitare, e cila ka ndikim dhe promovon kërkesën për qeverisje të mirë. Aktorët e shoqërisë civile konsiderohen nga LevizAlbania si forca kryesore lëvizëse për të kërkuar dhe sjellë ndryshime përmes qasjes nga poshtë - lartë. Gjithashtu, media luan një rol të rëndësishëm në proceset advokuese për influencimin e prioriteteve dhe vendimmarrjes vendore.

Thirrja për Aplikime Nr. 7 synon të forcojë dhe motivojë angazhimin qytetar duke mbështetur organizatat jofitimprurëse, veçanërisht organizatat lokale; grupet informale dhe individëd, të cilët kanë ide inovatore dhe angazhohen t'i shndërrojnë ato në aksione konkrete në të mirë të komunitetit dhe përmirësimit të nivelit të demokracisë vendore.

4. Kushtet për aplikim, madhësia e granteve dhe afati i zbatimit

⁷ [Capacity and Needs Assessment for CSOs in Albania, 2019](#)

- Drejtimit 1 dhe 2 janë të hapura për të gjithë OJF-të e regjistruara sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;
- Grupet Informale mund të aplikojnë në Drejtimit 2 dhe 3;
- Individët mund të aplikojnë vetëm në Drejtimin 3;
- OJF-të që aplikojnë Drejtimin 1 dhe planifikojnë të zbatojnë projekte jashtë zonës së qarkut ku operojnë duhet të kenë partneritet me OJF-të lokale, duke u dhënë këtyre OJF-ve lokale rol të rëndësishëm në menaxhimin operacional dhe financiar, në zbatimin e projektit;
- OJF-të që aplikojnë Drejtimin 2 dhe planifikojnë të zbatojnë projekte jashtë zonës së qarkut ku operojnë, ato duhet të jenë partnere me OJF-të lokale. Partneri lokal duhet të ketë rolin e liderit në aplikim (roli i organizatave më të konsoliduara në partneritet duhet të jetë i përqendruar më së shumti në ekspertizë dhe mbështetje).
- Grupet Informale dhe Individët mund të aplikojnë me koncept ide që propozojnë ndërhyrje vetëm në Bashkinë ku janë vendosur/ ku banojnë;
- Grantet për OJF do të variojnë nga **10,000 CHF** deri në **60,000 CHF**;
- Kufiri maksimal i granteve për Grupet Informale është **10,000 CHF**;
- Kufiri maksimal i granteve për Individë është **7,000 CHF**;
- Afati maksimal i zbatimit të projektit është **12 muaj**.

5. Kriteret e Vlerësimit

Kriteret kryesore për vlerësimin e koncept-ideve janë si më poshtë vijon:

- Përputhja e koncept-idesë me drejtimit/objektivat e thirrjes;
- Kuptueshmëri e mirëformular e problemit të identifikuar dhe adresim i duhur i tij (mungesa e identifikimit të qartë të problemit, përjashton konceptidenë nga vlerësimi i mëtejshëm);
- Qartësi dhe lidhje logjike në përcaktimin e qëllimit kryesor dhe objektiveve specifike;
- Strukturimi dhe planifikimi i aktiviteteve, si dhe lidhja logjike e tyre me objektivat dhe rezultatet e pritshme;
- Vlera e shtuar dhe risia që sjell ndërhyrja e propozuar.

6. Rregulla të Përgjithshme për Aplikimin dhe Informacion Shtesë

- Në Thirrjen për Aplikime lejohet aplikimi i OJF-ve, grupeve informale apo individëve me vetëm një projekt-ide;
- Ndërhyrjet e propozuara në një Bashki (ose komunitet) të caktuar propozohen nga individë/grupe informale/organizata që i përkasin asaj Bashkie. Nëse organizata nga Bashki të tjera propozojnë ndërhyrje në një Bashki tjetër, ato duhet të argumentojnë mirë pse dhe të krijojnë partneritet me aktorë lokal. Organizatat lokale kanë rol të rëndësishëm (shiko kushtet për secilin drejtim). Ato kanë një rol të qartë në zbatimin e ndërhyrjes dhe administrimin e buxhetit, gjë që do të pasqyrohet edhe në kontratën e grantit.
- Nuk mund të pranohen aplikime nga grantmarrës aktualë të LevizAlbania, që kanë një projekt granti në zbatim e sipër.

UDHËZUES I THIRRJES PËR APLIKIME NR. 7

- Nuk mund të pranohen aplikime/konceptide nga shoqatat e njësisve vendore.
- Nuk mund të pranohen aplikime/konceptide nga organizata të shoqërisë civile që kanë të përfshirë në strukturat e tyre, apo në grupet e punës të propozuar:
 - persona që janë në një konflikt interesi, në lidhje me statusin e tyre profesional ose personal;
 - persona që janë të punësuar në projekte të Organizatave/Donatorëve Ndërkombëtarë;
 - persona që janë të punësuar në administratën publike apo që janë pjesë e organeve të zgjedhura qendrore apo vendore;
- Rregulli i mësipërm vlen edhe për aplikuesit individë apo grupe informale, të cilët duhet
- gjithashtu të deklarojnë se nuk janë në një nga kushtet e përmëndura më sipër.
- OJF-të duhet të paraqesin vendimin më të fundit të marrë nga Gjykata, lidhur me statusin e tyre;
- Grupet informale duhet të dërgojnë CV të grupit (pasqyrim i aktiviteteve të kaluara të grupit si dhe emrat e anëtarëve kryesorë të tij), si dhe CV të koordinatorit apo përfaqësuesit të grupit për këtë projekt propozim;
- Individët që aplikojnë për Drejtimin 3 duhet të dërgojnë CV e tyre (vetëm CV-në e individit aplikant);
- LevizAlbania nuk njeh si shpenzim Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);

LevizAlbania kërkon nga aplikantët që në hartimin e koncept-ideve të tyre:

- të përfshijnë **perspektivën gjinore**;
- të **bashkëpunojnë me gazetarë dhe media** për të advokuar apo për të shpërndarë në publik mesazhet kryesore;
- të **stimulojnë vullnetarizmin**;
- të konsiderojnë në koncept-ide **bashkepunime** me organizata të tjera, individë dhe/ose grupe informale **me qëllim krijimin e koalicioneve të mundëshme**.

LevizAlbania NUK mbështet projekte/aktivitete që synojnë:

- Ofrimin e shërbimeve sociale;
- Realizimin e kompetencave/detyrave të pushtetit vendor;
- Trajnime të administratës vendore;
- Vetëm dhe kryesisht zhvillimin e tryezave të rrumbullakta / seminareve që nuk sjellin rezultat konkret e të prekshëm për qytetarët;

7. **Hapat e Thirrjes Nr. 7**

Mekanizmi i përzgjedhjes së projekteve më të mira të Thirrjes për Aplikime Nr. 7 të LevizAlbania kalon në tre faza që sigurojnë transparencë, përfshirjen e grupeve të interesit dhe cilësi të lartë të aplikimeve, në përputhje me drejtimet e thirrjes.

MEKANIZMI I PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE



• **Informimi dhe Aplikimi**

Gjatë periudhës që Thirrja Nr. 7 do të qëndrojë e hapur, LevizAlbania do të organizojë 2 sesione informuese online, në të cilat janë të ftuara organizata të shoqërisë civile, individë dhe grupe informale dhe të gjitha kategoritë e përmendura në fillim të udhëzuesit. Në sesionet informuese do të diskutohet mbi drejtimit dhe procedurat e thirrjes dhe do t’i jepet përgjigje të gjitha pyetjeve që kanë të interesuarit mbi Thirrjen për Aplikime. Sesionet informuese do të zhvillohen si më poshtë:

- 21 Korrik, 2020, ora 11.00
- 27 Korrik, 2020, ora 11.00

Për të siguruar një informacion sa më të gjerë për aplikantët e interesuar, LevizAlbania gjatë periudhës së Thirrjes Nr. 7 do të përfshijë në websiten e projektit link një seksion të dedikuar për Pyetje/ Përgjigje të Shpeshta.

• **Vlerësimi i konceptideve**

Vlerësimi i konceptideve bëhet me pikë për secilin kriter. Nga ky vlerësim do të përzgjidhen aplikantët më cilësorë, të cilët do të ftohen të marrin pjesë në Konkursin e Ideve.

Aplikantët të cilët nuk do të mund të vazhdojnë më tej procesin e konkurrimit, do të njoftohen me shkrim për vendimin dhe vlerësimin me pikë.

• **Konkurset e Ideve**

Aplikantët e përzgjedhur do të ftohen të prezantojnë konceptidenë e tyre gjatë “Konkursit të Ideve”. Konkursin e Ideve zhvillohen si rregull në tre qytete të ndryshme, megjithatë në varësi të situatës në vend, LevizAlbania vendos zhvillimin e Konkursit të Ideve përmes platformave të teknologjisë së informacionit.

Bordi i Granteve i përbërë nga përfaqësues dhe ekspertë të njohur të shoqërisë civile, qeverisjes vendore dhe medias nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, do të përzgjedhë idetë më cilësore që do të kalojnë në fazën e fundit, atë të hartimit të projektpropozimeve të plota.

Konkurset e Ideve janë të hapura për të gjithë aplikantët dhe transmetohen drejtpërsëdrejti në kanalet e medias sociale të LevizAlbania.

• **Përgatitja dhe vlerësimi i Projekt Propozimeve të Plota**

Gjatë kësaj faze aplikantët e përzgjedhur gjatë Konkurseve të Ideve do të përgatisin projektin e plotë, duke pasqyruar sugjerimet dhe komentet e bëra nga Bordi i Granteve.

Bordi i Granteve do të vlerësojë projekt propozimet e plota dhe do të marrë vendimin për fituesit. Kriteret e vlerësimit të Projekt Propozimeve të plota janë si më poshtë:

- Reflektim i rekomandimeve të Bordit të Grantit gjatë Konkurseve të Ideve;
- Vlerësim i kapaciteteve menaxhuese, financiare dhe ekspertizës së Organizatës/grupit informal/individit;
- Përputhja e buxhetit me objektivat dhe aktivitetet e Projektit.

Identifikimi i problemit është kyç për suksesin e një aplikimi. Seksioni që shtjellon identifikimin e problemit do të shqyrtohet me kujdes në të gjitha hapat e procesit të vlerësimit dhe në rast se një konceptide nuk paraqet një shtjellim të kënaqshëm të problemit dhe/ose Bordi i Granteve nuk është i kënaqur me shpjegimet e aplikuesit gjatë Konkursit të Ideve, atëherë aplikimi nuk mund të konsiderohet si një ide e vlefshme. Nga aplikanti do të kërkohet që të paraqitet në mënyrë të qartë ndërlidhja mes identifikimit të problemit në fazën e parë të konceptidesë dhe analizës së bërë në projektpropozimin e plotë. Kjo ndërlidhje do të jetë objekt vlerësimi nga Bordi i Granteve.

8. E Drejta e Ankimimit

Aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së një ankese, e cila duhet të bëhet jo më vonë se 5 pesë ditë pune nga data e dërgimit të informacionit me shkrim nga LevizAlbania (gjatë Konkursit të Ideve njoftimi bëhet drejtpërdrejtë).

Ankesa duhet të dërgohet me shkrim (email ose postë) nga vetë aplikanti dhe të përshkruajë qartë bazën e problemit/ankimimit. Përgjigja i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 5 pesë ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimimit.

9. Kufiri i financimit dhe Fondi në dispozicion

LevizAlbania, në kuadër të transparencës informon aplikantët dhe të gjithë të interesuarit se fondi në dispozicion për Thirrjen për Aplikime nr. 7 është rreth 820,000 CHF. Kufiri i financimit për një grant është i ndryshëm për kategoritë e ndryshme të aplikantëve, si më poshtë:

- Kufiri për OJF varion nga 10,000 CHF në 60,000 CHF
- Kufiri për Grupe Informale është 10,000 CHF
- Kufiri për Individë është 7,000 CHF